Vendim nr. 310, datë 30.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 30.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (S) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SELIMAN BARÇI,** i përfaqësuar nga avokati Kujtim Ibraj, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 75, datë 24.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; nr. 282, datë 11.02.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2026-33, datë 20.01.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 27, 30, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat ka regjistruar procedimin penal nr. 96 të vitit 1997 në ngarkim të kërkuesit për kryerjen prej tij të veprës penale "Vrasja me paramendim", të ndodhur në datën 18.07.1997 ndaj shtetasve P.I. dhe A.Gj, të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal (*KP*). Pas kryerjes se veprimeve hetimore, në datën 30.03.1998, ky procedim penal është pezulluar dhe aktet i kanë kaluar për hetim të mëtejshëm Komisariatit të Policisë së Rrethit Mat.

2. Po kështu, rezulton se në datën 10.11.1997, pak kohë pas kalimit të afatit për gjetjen e vrasësit, vëllai i viktimës P.I., shtetasi V.I., ka vrarë nipin e kërkuesit, shtetasin G.B. Pas grumbullimit të disa të dhënave, me qëllim sqarimin e vrasjes së shtetasve P.I. dhe A.Gj., aktet e procedimit penal i janë referuar organit të akuzës, në funksion të rifillimit të hetimeve për procedimin penal të pezulluar. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, pas analizimit të të dhënave dhe akteve të këtij procedimi penal, në datën 11.03.2009, ka vendosur shfuqizimin e vendimit për pezullimin e këtij procedimi penal dhe rifillimin e hetimeve. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, organi i akuzës ka arritur në përfundimin se autori i vrasjes së shtetasve P.I. dhe A.Gj. është kërkuesi dhe, në këto kushte, ka paraqitur çështjen për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale "Vrasja me paramendim", të parashikuar nga neni 78 i KP-së.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 75, datë 24.11.2009, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen dy herë të veprës penale "Vrasja me paramendim" ndaj shtetasve P.I. dhe A.Gj., të parashikuar nga neni 78 i KP-së, si dhe dënimin e tij me nga 20 vjet burgim për secilin episod. Bazuar në nenin 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, kërkuesi është dënuar përfundimisht me një dënim të vetëm me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. Sipas gjykatës së shkallës së parë, bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve (9 dëshmitarë), arrihet në përfundimin se autori i vrasjes së shtetasve P.I. dhe A.Gj. është kërkuesi. Po sipas asaj gjykate, fakti se viktimat janë vrarë me armë zjarri në datën 18.07.1997 provohet nga aktet e ekspertimit mjeko-ligjor të viktimave, procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes, tabelat fotografike, si dhe dëshmitë e dëshmitarëve. Gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale duke u përgatitur psikologjikisht dhe duke i marrë të gjitha masat për t'ia arritur qëllimit për eliminimin e dy viktimave, për të përfituar interesa mbi ndarjen e 60.000.000 (gjashtëdhjetë milionë) lekëve të vjetër. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim mbrojtësi i kërkuesit i zgjedhur nga familjarët e tij.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 664, datë 17.09.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 75, datë 24.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues. Sipas gjykatës së apelit, gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk rezulton që ndaj të pandehurit të jetë bërë ndonjë fletëthirrje në adresën e shtëpisë ku ai ka jetuar, për t'u paraqitur në gjykim, por ajo gjykatë është mjaftuar me prezencën e avokatit, duke mos e njoftuar për çdo seancë gjyqësore të shtyrë të pandehurin në vendbanimin e tij. Në këtë kuptim, sipas gjykatës së apelit, janë shkelur dispozitat e neneve 141, 142 dhe 143 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), që lidhen me mënyrën e njoftimit të të pandehurit që nuk gjendet. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs organi i akuzës.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 58, datë18.02.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 664, datë 17.09.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues. Sipas Kolegjit Penal, vetë gjykata e apelit e ka gjykuar çështjen në mënyrë të barasvlershme me atë të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket mbrojtësit të kërkuesit. Po sipas Kolegjit Penal, nëse ai mbrojtës nuk ka pasur tagra për të përfaqësuar kërkuesin në shkallë të parë, ai gjendet në të njëjtën situatë edhe gjatë gjykimit në apel, pasi është i njëjti mbrojtës, me të njëjtën prokurë, të dhënë nga motra e të pandehurit. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, edhe vetë gjykata e apelit ka shkelur procedurat e njoftimit të të pandehurit, pasi nga dosja gjyqësore rezulton se fletëthirrja e dërguar në banesën e të gjykuarit lidhur me njoftimin e tij për të marrë pjesë në seancën e datës 17.09.2010 është firmosur nga shtetasja E.S., në cilësinë e motrës të të pandehurit, e cila ka deklaruar se ai ndodhej jashtë shtetit dhe nuk kishte kontakte me të. Në këtë kuptim, sipas Kolegjit Penal, duke qenë se kjo mënyrë njoftimi në gjykatën e apelit nuk është e plotë dhe korrekte, pa u siguruar se i pandehuri do të marrë njoftim personalisht për procedimin në ngarkim të tij, sipas nenit 140 të KPP-së, pasi personi që ka nënshkruar njoftimin deklaron se i pandehuri ndodhet jashtë shtetit dhe nuk ka kontakte me të, gjykata e apelit duhet të vazhdonte me mënyrat e tjera alternative të njoftimit të parashikuara shprehimisht në nenet 140, 141 e 142 të KPP-së, duke zbatuar në mënyrë shteruese këto dispozita.

6. Pas rigjykimit të çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1088, datë 06.12.2013, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga avokati i kërkuesit ndaj vendimit nr. 75, datë 24.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Sipas gjykatës së apelit, mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e kërkuesit (e motra) për të marrë pjesë në gjykimin që zhvillohet në mungesë të të pandehurit për të mbrojtur interesat e tij, nuk është personi i legjitimuar nga dispozitat procedurale penale në fuqi për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 176, datë 28.10.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1088, datë 06.12.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Lartë, situata e përfaqësuesit të kërkuesit ka ndryshuar gjatë shqyrtimit të çështjes pranë saj, pasi me prokurën e datës 07.07.2015, të paraqitur në seancën gjyqësore të datës 28.10.2025, kërkuesi ka autorizuar të njëjtin mbrojtës që të veprojë për llogari të tij dhe ta përfaqësojë atë në mungesë në të gjitha shkallët e gjykimit dhe, po sipas së njëjtës prokurë, i pandehuri rezulton se ka dijeni për procesin penal në ngarkim të tij. Po sipas Kolegjit Penal, është e një rëndësie thelbësore që gjatë gjykimit në apel i pandehuri duhet të ketë mundësi të ushtrojë të drejtat e tij kushtetuese, siç janë e drejta për t'u dëgjuar, për të kërkuar marrjen e provave, nëpërmjet përsëritjes së hetimit gjyqësor, si elemente të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

8. Pas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1090, datë 20.09.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 75, datë 24.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Sipas asaj gjykate, nisur nga rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe në veçanti nga provat e administruara në gjykim, si ato shkresore, shkencore dhe me dëshmitarë, rezulton tërësisht e provuar se fakti ka ndodhur dhe së është provuar që autor i kësaj vepre penale është kërkuesi. Po sipas gjykatës së apelit, faktet e çështjes janë të qëndrueshme dhe në harmoni me njëra-tjetrën, të cilat formojnë e vërtetojnë në një linjë zinxhir të gjithë mekanizmin e ngjarjes, identifikimin e kërkuesit si autor të krimit dhe veprimeve të kryera prej tij në periudhën kohore kur ka ndodhur ky krim. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1519 (230), datë 20.09.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1090, datë 20.09.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas Kolegjit Penal, në seancën e zhvilluar në datën 27.06.2016, seanca e fillimit të gjykimit të verifikimit të konstituimit të palëve në proces, mbrojtësi i të pandehurit, ka paraqitur kërkesën me shkrim, duke kërkuar përsëritjen tërësisht të procesit gjyqësor, për të cilën gjykata e apelit nuk e ka trajtuar dhe as nuk është shprehur, duke e lënë këtë kërkesë pa vendimmarrje. Në këtë kuptim, sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit duke mos u shprehur lidhur me kërkesën e të pandehurit për "riçeljen dhe përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor", ka kompromentuar edhe paanësinë e saj në gjykimin e asaj çështjeje, për sa kohë që "mosprononcimi në momentin e fillimit të gjykimit dhe vazhdimi i gjykimit, pavarësisht paraqitjes dhe trajtimit të kësaj kërkese", presupozonin, minimalisht mosvlerësimin edhe të përmbajtjes së saj.

10. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 282, datë 11.02.2025, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 75, datë 24.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen dy herë të veprës penale "Vrasja me dashje", të parashikuar nga neni 76 i KP-së, në dëm të shtetasve P.I. dhe A.Gj., si dhe dënimin e tij me nga 16 vjet burg për secilin episod. Gjykata e apelit, në aplikim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, e ka dënuar kërkuesin me një dënim të vetëm prej 23 (njëzet e tre) vjetësh burgim. Gjatë rigjykimit në gjykatën e apelit, kjo e fundit, në zbatim edhe të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, ka vlerësuar se për shkak të zhvillimit të gjykimit në mungesë të të pandehurit në shkallë të parë, si dhe vlerësimit të dëshmive dhe provave të marra në atë shkallë, në respektim të parimit të kontradiktoritetit, në prezencë tij, duhet ta pranojë kërkesën dhe të përsërisë tërësisht shqyrtimin gjyqësor, duke shqyrtuar provat shkresore dhe provat me dëshmitarë.

11. Gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, gjykata e apelit ka administruar dëshmitë e shtatë shtetasve, si dhe procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, datë 19.07.1997, aktin e ekspertimit tekniko-balistik nr. 4651, datë 17.06.2009, si dhe ekspertimin mjeko-ligjor, datë 19.07.1997. Sipas gjykatës së apelit, bazuar në këto prova dhe nga faktet e çështjes krijohet bindja tej çdo dyshimi të arsyeshëm se autori i vrasjes së shtetasve P.I. dhe A.Gj. është kërkuesi. Kjo bindje i është krijuar gjykatës së apelit edhe nga fakti se deri përpara ngjarjes i pandehuri ka qenë se bashku me viktimat, ku me vete kanë pasur një armë zjarri pistoletë dhe nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor dhe tekniko-balistik, vrasja e tyre është bërë me armë zjarri, gëzhojat e së cilës përkojnë edhe me pistoletë TT model 54 kalibri 7.62 mm. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, sjellja e kërkuesit pas kryerjes së veprës penale, duke u larguar jashtë shtetit, gjakmarrja midis familjes së shtetasit P.I. dhe Barçi, si dhe ndërmjetësimet për t'u pajtuar, pasi ishin baras (gjaku ishte larë me gjak), konfirmojnë në mënyrë të padyshimtë se ka qenë i pandehuri ai që ka vrarë dy shokët e tij. Po sipas gjykatës së apelit, nga komunikimet e kërkuesit me dëshmitarët R.K. dhe F.B., rezulton se ai e ka pranuar që ka qenë ai vrasësi i shtetasit P.I. dhe rrjedhimisht edhe i shtetasit A.Gj., dhe se pas vrasjes së nipit të tij, duke qenë se ishin "barazuar", duhet të merrte fund edhe gjakmarrja midis dy familjeve.

12. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, dëshmia e dhënë nga shtetasi B.I. përputhet me deklarimet e dhëna nga F.B., i cili konfirmon komunikimet për pajtim nëpërmjet miqve të përbashkët, për të cilat kishte dijeni edhe i pandehuri, i cili e kishte marrë në telefon vëllain e tij për herë të parë pas shumë kohësh dhe kishte pranuar autorësinë e vrasjes së shtetasit P.I., duke sugjeruar për t'u pajtur me familjen e tij, pas vrasjes së nipit, shtetasit G.I. Për sa i takon akuzës së ngritur, se kërkuesi e ka kryer vrasjen me paramendim, gjykata e apelit ka vlerësuar

se nuk konstaton asnjë provë që të provojë paramendimin e të pandehurit në kryerjen e veprës. Po kështu, gjykata e apelit ka marrë nën shqyrtim dhe pretendimin e kërkuesit dhe përgjatë gjykimit në mungesë ai nuk është njoftuar për çdo seancë gjyqësore, duke e vlerësuar atë të pabazuar, për shkak se sipas gjykatës së apelit ai është njoftuar rregullisht sipas neneve 141 e vijues të KPP-së, dhe më tej është vijuar me gjykimin në mungesë. Po kështu, gjykata e apelit ka arsyetuar se mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e kërkuesit (e motra), më pas është rikonfirmuar vetë prej tij për ta përfaqësuar atë në gjykim. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

13. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-33, datë 20.01.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Lidhur me pretendimin e kërkuesit se nuk ka prova që vërtetojnë fajësinë e tij për veprën penale që është akuzuar dhe se gjykata e apelit, në vendimmarrjen e saj për deklarimin fajtor të tij është mbështetur në dëshmi kontradiktore, Kolegji Penal ka arsyetuar se sipas nenit 152, pika 2, të KPP-së, ekzistenca e një fakti mund të nxirret edhe nga indicet, kur ato janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Sipas Kolegjit Penal, në rastin konkret, këto elemente janë mbajtur në konsideratë gjatë arsyetimit dhe analizës së provave nga gjykata e apelit dhe se të gjitha pretendimet e ngritura nga mbrojtja kanë marrë përgjigje gjatë gjykimit në gjykatën e apelit. Po sipas Kolegjit Penal, konkluzioni dhe arsyetimi i gjykatës së apelit plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, ku konkluzioni i arritur është logjik dhe në përputhje me standardin "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" dhe nuk rezulton që gjykatat ta kenë filluar procesin ndaj të pandehurit me bindjen se ai e ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, shtrirja në kohë e gjykimit të çështjes së kërkuesit ka ardhur për t`i garantuar atij të drejtën e një mbrojtjeje efektive të parashikuar nga ligji procedural penal dhe Kushtetuta. Në përfundim, Kolegji Penal ka vlerësuar se në çështjen konkrete nuk konstatohet shkelje ose zbatim i gabuar i ligjit penal material, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk verifikohen shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose shkelje të tilla procedurale që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit; nuk rezulton që vendimmarrja e gjykatave të faktit të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

14. Në datën 20.05.2026 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 04.06.2026.

15. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

16. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

16.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e kanë dënuar kërkuesin vetëm mbi bazën e deklarimeve të dëshmitarëve, të cilët jo vetëm që kanë rezultuar në konflikt interesi, por kanë qenë dhe kontradiktore, të paqarta dhe të papajtueshme me njëra-tjetrën. Fajësia e kërkuesit nuk është provuar me prova të plota, të drejtpërdrejta, të besueshme dhe të verifikueshme. Në procedimin e kërkuesit nuk është paraqitur asnjë provë faktike, materiale ose shkencore që të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e kërkuesit. Vendimet gjyqësore, përfshirë edhe atë të Gjykatës së Lartë, janë të paarsyetuara në këtë drejtim.

16.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi trup gjykues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, me vendimin nr. 00-2026-33, datë 20.01.2026, është i njëjti me atë që me vendimin nr. 00-2022-1519 (230), datë 20.09.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1090, datë 20.09.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Pra, kërkuesi për të njëjtën çështje është gjykuar nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë si në vitin 2022, ashtu edhe në vitin 2026.

16.3. *E drejta e mbrojtjes,* pasi kërkuesi është gjykuar në mungesë nga gjykata e shkallës së parë dhe është privuar nga e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Gjykata e apelit duhej t'i garantonte rivendosjen e plotë të kësaj të drejte të kërkuesit dhe jo në shqyrtimin formal të çështjes.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranushmërisë së kërkesës

17. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

19. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i Ligjit Organik të Gjykatës, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se, për sa i përket aspektit substancial të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *së drejtës së mbrojtjes,* pasi, sipas tij, ai është gjykuar në mungesë nga gjykata e shkallës së parë dhe është privuar nga e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Po sipas kërkuesit, gjykata e apelit duhej t'i garantonte rivendosjen e plotë të kësaj të drejte dhe jo hqyrtimin formal të çështjes. Në lidhje me këto argumente të kërkuesit të sjella në drejtim të cenimit të së drejtës së mbrojtjes, referuar kërkesës dhe materialeve të ardhura me të, Kolegji konstaton se ai nuk i ka ngritur ato në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye ai nuk ka shteruar

mjetet juridike efektive në aspektin substancial për këto pretendime, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

21. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji vëren se atë për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* kërkuesi e ka ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, ndërsa pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* e ngre për vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, konsiderohet se ai i ka shteruar mjetet juridike për këto pretendime.

22. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i datës 20.01.2026, i është komunikuar mbrojtësit të kërkuesit në adresën e tij të postës elektronike në datën 18.03.2026, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 20.05.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

23. Për sa i përket kriterit të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi, sipas tij, ai është dënuar nga gjykatat vetëm nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe se nuk ka asnjë provë tjetër që të vërtetojë fajësinë e tij në kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë arsyetuar në këtë drejtim dhe vendimet e tyre nuk plotësojnë standardin e një vendimi të arsyetuar.

24. Gjykata ka theksuar se në rastin e gjykimit penal parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Po kështu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet

42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes *(shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më lart, në analizë të vendimmarrjeve së gjykatave të zakonshme dhe të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ato gjykata kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk u kanë dhënë prioritet provave të paraqitura nga organi i akuzës, nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Po kështu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji konstaton se gjykatat në vendimet e tyre kanë arsyetuar mjaftueshëm për dëshmitë e dëshmitarëve, duke i vlerësuar ato në raport me provat dhe indiciet e tjera të administruara në gjykim, siç janë aktet e ekspertimit mjeko-ligjor të viktimave, akti ekspertimit tekniko-balistik nr. 4651, datë 17.06.2009, procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes ose tabelat fotografike. Në këtë drejtim, gjykata e apelit ka mbajtur në konsideratë faktin se përpara ngjarjes kërkuesi ka qenë së bashku me viktimat dhe se ata kishin me vete një armë zjarri pistoletë, ndërsa nga aktet e ekspertimit mjeko-ligjor dhe tekniko-balistik ka rezultuar se vrasja është kryer me armë zjarri dhe se gëzhojat përkojnë me pistoletën TT, modeli 54, kalibri 7.62 mm. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se dëshmia e shtetasit B.I. përputhet me deklarimet e dëshmitarit F.B. lidhur me komunikimet për pajtim ndërmjet familjeve, duke mbajtur në konsideratë edhe komunikimet e

kërkuesit me dëshmitarët R.K. dhe F.B., nga të cilat ka rezultuar pranimi prej tij i autorësisë së vrasjes së shtetasit P.I.

28. Nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara rezulton se gjykatat i kanë vlerësuar provat në ngarkim të kërkuesit në raport me njëra-tjetrën, duke i dhënë edhe mundësinë atij që, në kushte të barabarta me organin e akuzës, të parashtrojë pretendimet e tij dhe të kundërshtojë akuzën e ngritur dhe provat mbi të cilat është ngritur kjo akuzë, si dhe të paraqesë prova e të debatojë në lidhje me to. Gjykatat kanë arritur në përfundimin për dënimin e kërkuesit pa i dhënë ndonjërës prej provave të shqyrtuara vlerë të paracaktuar. Nga arsyetimi i gjykatave, vendimet e të cilave janë kundërshtuar nga kërkuesi, rezulton se ato kanë arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuesit, pasi kanë kryer një proces të shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të administruara në gjykim, duke mos arritur në një konkluzion *a priori* për fajësinë e tij, dhe duke mos u bazuar vetëm në dëshmitë e dëshmitarëve, por e kanë përcaktuar atë tej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke arsyetuar mjaftueshëm në këtë drejtim.

29. Ky pretendim i kërkuesit (parimi i prezumimit të pafajësisë) ka marrë përgjigje të arsyetuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë ligji, bazuar edhe në parimin e subsidiaritetit, ka arsyetuar se arsyetimi i gjykatës së apelit plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, ku konkluzioni i arritur është logjik dhe në përputhje me standardin "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm", dhe nuk rezulton që gjykatat ta kenë filluar procesin ndaj të pandehurit me bindjen se ai e ka kryer krimin për të cilin akuzohet.

30. Për sa më lart, Kolegji evidenton se kërkuesi është gjykuar mbi bazën e të gjitha provave të lartpërmendura të ndodhura në fashikullin gjyqësor, të cilat janë vlerësuar nga gjykatat se provojnë fajësinë e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndaj nuk qëndron argumenti se gjykatat të kenë arritur në një konkluzion *a priori* për fajësinë e tij dhe se vendimet e tyre janë të paarsyetuara në këtë drejtim. Referuar vendimeve gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi, Kolegji konstaton se ato kanë arsyetuar mjaftueshëm në këtë drejtim dhe arsyetimi i tyre nuk duket haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar që të ketë sjellë një gjykim të padrejtë ndaj kërkuesit. Për këto arsye, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

31. Po kështu, në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar dhe cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi sipas tij i njëjti trup gjykues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që në vitin 2022 ka prishur vendimin nr. 1090, datë 20.09.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, ka gjykuar edhe rekursin e paraqitur prej tij në vitin 2025, për të cilin

ka vendosur mospranimin e rekursit. Pra, sipas kërkuesit, për të njëjtën çështje është gjykuar nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë si në vitin 2022, ashtu edhe në vitin 2026.

32. Gjykata ka pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shihet që bëhet *(shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë *(vendimet nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj ka mbajtur në konsideratë gjithashtu jo vetëm pozicionin dhe rolin kushtetues të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta *(shih vendimet nr. 20, datë 22.09.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 3, datë 06.02.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*, por edhe funksionin që kryejnë kolegjet e saj në seleksionimin e rekurseve që nuk përmbajnë shkaqe të parashikuara nga ligji *(shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 06, datë 16.02.2021; nr. 64, datë 16.10.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë drejtim, respektimi i parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Lartë vlerësohet në këndvështrim të rrethanave të veçanta të çështjeve konkrete të lidhura me procesin që zhvillohet në atë gjykatë, si dhe me natyrën dhe kompleksitetin e çështjes (*shih vendimin nr. 21, datë 26.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Po në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pranuar se ekzistojnë dy situata të cilat mund të krijojnë dyshimin për paanshmëri, ato të natyrës funksionale që lidhen me ushtrimin e një funksioni tjetër në procesin gjyqësor nga i njëjti gjyqtar dhe të natyrës personale, që lidhen me sjelljen e gjyqtarit në çështjen konkrete (*shih Kyprianou kundër Qipros, datë 15.12.2005, § 121*). Për sa i përket natyrës funksionale, ajo gjykatë është shprehur se fakti që gjyqtari ka njohuri të hollësishme të çështjes nuk përbën paragjykim që do ta konsideronte atë të anshëm gjatë marrjes së vendimit të themelit (*shih Morel kundër Francës, datë 06.06.2000, § 45*).

35. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se çështja gjyqësore e kërkuesit është gjykuar në Gjykatën e Lartë, ndër të tjera, në vitin 2022 dhe në vitin 2026. Në të dyja rastet ajo gjykatë

është vënë në lëvizje me rekursin e vet kërkuesit. Në shqyrtimin e këtyre rekurseve të kërkuesit kanë marrë pjesë të njëjtët gjyqtarë në përbërje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Po kështu, ndërsa në rastin e rekursit të shqyrtuar në vitin 2022 nga Gjykata e Lartë, kjo e fundit e ka kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apelit, duke mos u shprehur për themelin e çështjes, pra pa mbajtur një qëndrim për zgjidhjen e çështjes në fjalë, për shkak se faktet dhe aktet duhet të verifikoheshin nga gjykata e apelit, e cila duhej të riçelte dhe të përsëriste shqyrtimin gjyqësor, sipas kërkesës së mbrojtësit të kërkuesit, në rastin e rekursit të shqyrtuar në vitin 2026, Gjykata e Lartë ka dhënë vendim për mospranimin e tij, pra një vendim që ka shqyrtuar vetëm ekzistencën ose jo të shkaqeve ligjore në rekurs, pa vlerësuar themelin e çështjes.

36. Në analizë të këtyre fakteve, Kolegji vlerëson se edhe pse Gjykata e Lartë formalisht ka pasur për shqyrtim në të dyja rastet rekurset e paraqitura nga kërkuesi, në thelb ka shqyrtuar çështje të ndryshme juridike. Në këtë pikë vihet në dukje se kur Gjykata ka shqyrtuar pretendime për cenimin e parimit të paanësisë për shkak të pjesëmarrjes të të njëjtit gjyqtar në dhënien e dy vendimeve në atë gjykatë, ka analizuar nëse vendimet e kundërshtuara janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve *(shih vendimin nr. 22, datë 20.05.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

37. Në analizë këtyre fakteve, Kolegji vlerëson se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

38. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat "d" dhe "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.